



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj



MEDIAT JO-SOCIALE

Hulumtimi dhe ekspozimi i dezinformimit gjinor në Kosovë

2023



Ky raport është mundësuar me mbështetjen e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID në Kosovë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë. Opinionet e shprehura këtu janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e NDI-së, USAID-it, UNDP-së ose ndonjë individi të organizatave të lartpërmendura.

Mbështetja e UNDP-së në Kosovë u bë e mundur përmes kontributeve bujare nga Luksemburgu, Republika e Koresë dhe Norvegjia, përmes Dritares së Financimit. Si mjeti kryesor i UNDP-së për financimin tematik, Dritarja e Financimit i mundëson UNDP-së t'u përgjigjet me shpejtësi dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse nevojave dhe sfidave të reja në mbarë botën.

Copyright © Democracy for Development - D4D 2023. Të gjitha të drejtat e rezervuara.



Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje	6
Gjetjet Kryesore	7
Metodologjia.....	8
Dhuna dhe dezinformimi gjinor online.....	9
Mizogjinia.....	10
Diskursi i urrejtjes kundër komuniteteve të marginalizuara	22
Mostra e gjuhës së urrejtjes – sipas gjinisë	24


Përmbledhje

Qëllimi i këtij raporti është hulumtimi dhe zbulimi i dezinformimit gjinor, i cili përbën një trend shqetësues në shpërndarjen e lajmeve dhe informacionit përmes platformave të rrjeteve sociale dhe online.

Targetimi joproporcional i bazuar në gjini dhe orientim seksual, veçanërisht i atyre që janë në sytë e publikut siç janë politikanet, është një fenomen i zakonshëm i fushatave të dezinformimit dhe dhunës online. Efektet e fushatave të tilla dëmtojnë besueshmërinë e grave udhëheqëse, duke ndikuar potencialisht në perceptimin publik dhe në rezultatet e zgjedhjeve. Dhuna dhe ngacmimet online, të karakterizuara nga komente seksiste dhe mizogjene, janë

më të përhapura për gratë dhe personat LGBTQI+, veçanërisht në rrjete sociale, si dhe mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e tyre mendore.

Dezinformimi gjinor dhe dhuna online kanë kontribuar në polarizimin politik, duke nxitur një mjedis armiqësor online që mund t'i dekurajojë gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara nga pjesëmarrja aktive në jetën qytetare.



Gjetjet Kryesore

- > **Pabarazia gjinore në dhunën dhe ngacmimet online:** Pas analizimit të komenteve nga artikujt që përmbajnë dezinformim gjinor, zbuluam se gratë ndeshen me dhunë dhe ngacmim online më shpesh nga burrat sesa nga gratë (burrat shkruajnë 89.6% të komenteve me gjuhë të urrejtjes kurse gratë 10.4%). Me zberthimin sipas gjinisë të të dhënave nga të gjitha komentet në artikuj, u bë e qartë se burrat shfaqnin një shkallë më të lartë të përfshirjes në dhunën dhe ngacmimet online të drejtuar ndaj grave.
- > **Ndërveprim më i lartë në përmbajtjen me dezinformim gjinor:** Artikujt e lajmeve me dezinformim gjinor në media gjenerojnë një ndërveprimet dukshëm më të lartë në krahasim me artikujt e përgjithshëm të lajmeve. Mesatarisht, rastet e dezinformimit gjinor në media mbledhin mbi 86 reagime për lajm - tri herë më i lartë se ndërveprimii tipik për të gjitha lajmet.
- > **Targetimi i qëllimshëm:** Gratë, veçanërisht ato që janë në sytë e publikut, si politikane dhe figura publike, targetohen shpesh nga fushata dezinformuese në krahasim me burrat.
- > **Minimi i besueshmërisë:** Fushatat e dezinformimit shpesh minojnë besueshmërinë e grave në pozita udhëheqëse. Kjo mund të sjellë pasoja, duke ndikuar në perceptimin publik dhe duke ndikuar potencialisht në rezultatet elektorale.
- > **Dhuna dhe ngacmimet online:** Gratë dhe personat LGBTQI+ përjetojnë nivele më të larta të ngacmimeve online, duke përfshirë komente seksiste dhe mizogjene dhe me gjuhë të urrejtjes. Platformat e rrjeteve sociale janë hapësira të zakonshme për ngacmime të tilla, duke ndikuar në shëndetin mendor dhe mirëqenien e individëve të targetuar.
- > **Sfidat ndërsektoriale:** Nga këndvështrimi ndërsektorial, gratë e shtresave të ndryshme të marginalizuara mund të përballen me fushata të shtuara të dezinformimit që shfrytëzojnë dimensionet e shumta të identitetit të tyre, si raca, përkatësia etnike ose orientimi seksual.
- > **Polarizimi politik:** Dezinformimi gjinor po kontribuon në polarizimin politik duke nxitur një mjedis armiqësor online në Kosovë. Kjo mund të dëmtojë përfshirjen në demokraci dhe mund të jetë pengesë që gratë dhe personat LGBTQI+ të hyjnë në politikë ose të angazhohen në diskutimin publik, duke kufizuar pjesëmarrjen e tyre në jetën qytetare dhe publike.
- > **Kritika online:** D4D dhe Pikasa Analytics kanë vërejtur sulme të dukshme online ndaj femrave figura publike që vendosin të kundërshtojnë homologët e tyre meshkuj. Gratë që bëjnë pyetje ose i sfidojnë kolegët e tyre meshkuj përjetojnë sulme të theksuara në rrjete sociale.

>



Metodologjia

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) dhe Pikasa Analytics, të mbështetur nga Instituti Kombëtar Demokratik - NDI në Kosovë dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP në Kosovë, kanë realizuar një analizë të plotë të rrjeteve sociale dhe mediave online, duke mbuluar periudhën dyvjeçare për të identifikuar lajme/artikuj që përmbajnë çrregullime të informacionit.¹

Monitorimi siguroi të dhëna të matshme për ndërveprimin total në artikujt e mediave online dhe postimet në rrjete sociale me çrregullime informacioni nga janari 2022 deri në nëntor 2023. Për qëllimin e këtij raporti, Instituti D4D dhe Pikasa Analytics i monitoruan dhe analizuan artikujt dhe postimet në rrjete sociale përmes prizmit së dezinformimit gjinor, për të ofruar një pasqyrë dhe për t'i kuptuar më në thellësi fenomenet, për të ndihmuar në identifikimin e masave që rrisin vetëdijesimin dhe ndihmojnë në luftimin e dezinformimit gjinor në peizazhin mediatik të Kosovës. (Në disa raste, janë përdorur dy platforma të tjera për monitorimin e rrjeteve sociale, duke përfshirë CrowdTangle dhe MediaToolkit, me fokus në monitorimin dhe analizimin e lajmeve kundër grave, personave LGBTQI+, pakicave etnike dhe personave me aftësi të kufizuara).

Fillimisht, çrregullimet e informacionit u identifikuan në gjuhën shqipe dhe serbe, dhe më pas u përzgjedhën për analiza të mëtejshme artikujt me ndërveprimin më të lartë të përgjithshëm online. Gjithashtu, Pikasa Analytics, e angazhuar nga UNDP, ka realizuar një hulumtim cilësor për këtë raport. Pikasa Analytics ka intervistuar disa nga gratë deputete më të sulmuara për të ofruar një analizë më të thelluar për raportin.

Monitorimi i çrregullimeve të informacionit është realizuar përmes platformës Pikasa Analytics. Mediat online dhe rrjetet sociale të monitoruara përmes platformës përfshinin më shumë se 100 media lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Monitorimi dhe analiza e artikujve me çrregullime të informacionit është bërë njëkohësisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Përzgjedhja e shembujve nga të dy mostrat u bazua në përmbajtjen e artikujve përmes prizmit së dezinformimit gjinor, duke u fokusuar në dezinformimin, keqinformimin, manipulimin e fakteve, përmbajtjen e paverifikuar, teoritë konspirative, "click baits", gjuhën e urrejtjes, gjuhën fyese, gjuhën kërcënuese dhe artikujt me tituj tendenciozë.

Monitorimi i rrjeteve sociale dhe mediave online përfshiu këto platforma të rrjeteve sociale: Facebook, X (ish Twitter), Instagram, TikTok dhe portalat e lajmeve online që operojnë në Kosovë. Mbi 110 portale në Kosovë, publikojnë çdo ditë mesatarisht 5,495 artikuj. Thënë ndryshe, gjatë gjithë periudhës së monitoruar (22 muaj) platforma ka kapur 3,626,700 artikuj lajmesh. Të gjithë këta artikuj fituan 83.6 milion ndërveprime (pëlqime, shpërndarje, komente). 23 rastet më me ndikim në media që kemi analizuar për raportin janë trajtuar përmes 2,429 artikujve në media dhe kolektivisht kanë 210,541 ndërveprime.

¹ Për më shumë informacion, shih ÇRREGULLIMIN E INFORMACIONIT: Drejt një kornize ndërdisiplinore për hulumtime dhe hartim të politikave. Burimi: <https://rm.coe.int/information-disorder-toward-an-interdisciplinary-framework-for-research/168076277c>

Dhuna dhe dezinformimi gjinor online

“Ka një lidhje ndërmjet mizogjinisë dhe abuzimit që gratë përjetojnë drejtpërdrejt dhe online... Rrjetet sociale janë thjesht një mënyrë tjetër për t'i kryer këto akte. Në fund të fundit, problemi është mizogjia që qëndron pas kësaj. Pra, ne duhet të trajtojmë jo vetëm mjetet me të cilat njerëzit janë në gjendje të përhapin urrejtjen, mizogjininë dhe abuzimin e tyre”²

Epoka e internetit u pranua lehtësisht dhe me gëzim nga gratë. Trendet globale kanë treguar se gratë më shumë se burrat janë kujdestare, sakrifikojnë karrierën e tyre për familjen dhe janë më pak në gjendje të marrin pjesë aktive në jetën publike.³ Përvoja me pandeminë COVID-19 tregoi gjithashtu se se ku u mirëpritën zgjidhjet e digjitalizuara.⁴ Megjithatë, hapësira online nuk doli të ishte një mjedis miqësor për gratë që donin të shprehnin opinionet e tyre, dhe as rrjete sociale nuk ishin një mundësi socializimi. Kur gratë shprehnin opinionet e tyre ose kritikonin ndonjë abuzim ose shkelje të të drejtave, reagimi online kundër tyre përfshinte kërcënime për përdhunim, vrasje ose lloje të tjera të dhunës online.

Dhuna online ndaj grave në hulumtim përfaqësohet si rezultat i një sistemi dhe qëndrimi më të thellë patriarkal ndaj grave. Meqenëse një sistem patriarkal përfshin përpjekjet sistemike për nënshtrimin e grave, urrejtja dhe mizogjia online u japin një karakter më të errët qëndrimeve patriarkale.

Dhuna online kundër grave (DHOKG) në politikë është një kërcënim në rritje për demokracinë në mbarë botën. DHOKG përfshin forma të ndryshme agresioni dhe frikësimi që synojnë përjashtimin e grave nga politika vetëm bazuar në gjininë e tyre. Dezinformimi gjinor, një lloj dhune, shfrytëzon narrativa të njëanshme për të arritur qëllime politike, duke targetuar gratë individuale për të dekurajuar përfshirjen e tyre në jetën publike dhe për të dërguar një mesazh më të gjerë kundër grave në politikë.⁵

Ky raport monitorues ka konstatuar një trend shqetësues të dhunës online që targeton gratë politike në Kosovë. Shumica e artikujve që shfaqin nivelet më të larta të ndërveprimit dhe që janë analizuar për këtë raport, ilustrojnë një model në rritje të fushatave të dezinformimit gjinor të krijuara posaçërisht për të targetuar gratë në role politike.

2 Amnesty International, Twitter-i toksik – një vend toksik për gratë, mars 2018, <https://www.amnesty.org/en/latest/research/2018/03/online-violence-against-women-chapter-1/>.

3 <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/19994.pdf>

4 L. Taylor, Dashuria, kapja dhe abuzimi online në kohën e koronavirusit, në Thomson Reuters Foundation, 2 janar 2021, <https://news.trust.org/item/20210104110922-bqn8t>.

5 NDI “Dhënia fund dhunës online kundër grave”, për më shumë informacion: <https://www.ndi.org/ending-online-violence-against-women-politics>

Mizogjinia

“Qëllimi i dhunës kundër grave në politikë është të ruajë rolet dhe stereotipet tradicionale gjinore dhe të ruajë pabarazitë strukturore dhe në baza gjinore. Ajo mund të marrë shumë forma, nga sulmet verbale mizogjene dhe seksiste deri te aktet më të zakonshme të ngacmimit dhe ngacmimit seksual, shumica e tyre gjithnjë e më shumë online, apo edhe femicid”⁶

Rritja e ndërveprimit online ka rritur gjithashtu vëmendjen globale ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me gratë dhe përvojat e tyre, ngacmimet dhe dhunën, si virtualisht ashtu edhe në realitet. Teksa interneti dhe hapësira kibernetike kanë qenë një platformë e mirëpritur për gratë që të marrin pjesë publikisht dhe të shprehin opinionet e tyre për çështjet politike dhe sociale, në të njëjtën kohë, hapësira online dhe gratë janë bërë objekt dhe cak në hapësirën online përmes formave të ndryshme të dhunës, por kryesisht mizogjinisë të shprehur në tekste dhe online.

Akte të tilla e dëmtojnë rëndë pjesëmarrjen e grave në sferën publike, ndërkohë që sulmet kanë bërë që hapësira publike online të shprehë dhe përhapë urrejtje mizogjene, veçanërisht kundër grave në politikë dhe vendimmarrje. Ky raport ka evidentuar rritje të dhunës online kundër grave në politikë dhe vendimmarrje, si dhe të mizogjinisë online, dhe këto vazhdojnë të jenë fenomene me rritje të rrezikshme dhe diskriminuese që kontribuojnë në vazhdimin e një mentaliteti social patriarkal. Për më tepër, mizogjinia online krijon një mjedis kibernetik të pasigurt për gratë dhe mund të përfaqësojë lehtësisht një mjet për përhapjen e urrejtjes në baza gjinore, e cila mund të rrisë veprimet e dhunshme kundër grave.


Në këtë raport përdoren një sërë termash duke përfshirë dhunën, urrejtjen dhe mizogjininë. Për ta kuptuar përdorimin e termave për qëllimin e këtij punimi, termi mizogjini përdoret sipas përkufizimit të Baker dhe Jurasz se Mizogjinia është manifestimi i armiqësisë ndaj grave vetëm sepse ato janë gra. Mizogjinia online është manifestimi i armiqësisë që komunikohet përmes platformave online, veçanërisht rrjeteve sociale dhe mjediseve të tjera pjesëmarrëse.⁷

Në një shoqëri globale dhe gjithnjë e më të digjitalizuar, për fat të keq interneti po ofron stereotipe gjinore dhe veçanërisht sjelljes patriarkale të pranuar dhe të pakundërshtuar. Për më tepër, ky raport ofron një pasqyrë të llojeve të mizogjinisë online, dhe gjuhës mizogjene ndaj grave në politikë, nivele vendimmarrëse, gazetare dhe grave të tjera, fjalët ose veprimet e të cilave u përballën me qasje mizogjene nga homologët e tyre meshkuj. Teksa shoqëria kosovare punon për të ndryshuar mënyrën si i shohin qytetarët rolet gjinore, mizogjinia online e pengon përparimin.


Ky raport ka treguar manifestimin e mizogjinisë online në abuzimin online në baza gjinore kundër grave në politikë dhe në gjuhën e përdorur nga përdoruesit e rrjeteve sociale, në mbështetje të homologëve të tyre politikanë meshkuj, të cilët përfshihen në narrativën qendrore të storjeve mediatike.

6 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Raporti i Raportuesit Special për dhunën kundër grave, shkaqet dhe pasojat e saj në dhunën kundër grave në politikë (Publikimi i OKB-së, A/73/301, 6 gusht 2018), para. 13
7 Barker, K., & Jurasz, O. (2019). MIZOGJINIA ONLINE: NJË SFIDË PËR FEMINIZMIN DIGJITAL? *Journal of International Affairs*, 72(2), 95-114. <https://www.jstor.org/stable/26760834>

Artikujt e përzgjedhur më poshtë nëpërmjet metodologjisë së përdorur në këtë raport, synojnë të tregojnë dhe të rrisin vetëdijesimin për format e mizogjinisë që përdoren në hapësirën online. Edhe pse jo të gjitha komentet mund të përkufizohen si mizogjene nga natyra, ato prapëseprapë klasifikohen si paragjykitime kundër grave në politikë, të rrënjësura thellë në stereotipet gjinore dhe dëshirën për nënshtrim të grave.




Një nga politikanet më të sulmuara në Kosovë gjatë viteve të fundit ishte Mimoza Kusari-Lila. Vendimet dhe zgjedhjet e saj politike nuk e bënë objekt i diskutimit politik aq sa u bënë objekt i gjuhës paragjyquese dhe urrejtjes online, të përdorur në një kontekst mizogjen. Ky artikull që përmban një qasje mizogjene për kohëzgjatjen e prezencës së znj. Kusari-Lila në politikë, vërehet përmes optikës gjinore dhe qasjes me urrejtje gjinore, veçanërisht qasjes tradicionale për nderin e gruas, e cila vazhdon të jetë një nga elementet kryesore nënshtruese të grave nga shoqëria në Kosovë. Ky artikull ka arritur 1968 lexues dhe ka pasur 382 ndërveprime duke përfshirë 318 pëlqime, 57 komente si dhe 7 shpërndarje. 20% e komenteve në Facebook që iu përgjigjën këtij artikulli përmbanin gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë nxitëse kundrejt deputetes Kusari.




Në një kontekst të ngjashëm, deputetja Mimoza Kusari është sulmuar verbalisht në Kuvendin e Kosovës me tone seksiste, duke gjykuar jetëgjatësinë e deputetes Kusari Lila në politikë dhe faktin se gjatë karrierës së saj ajo është bërë pjesë e partive të ndryshme poli-


tike. Kryetitulli “Kusari-Lila u përkiste të gjithëve” konsiderohet gjinor dhe mizogjen dhe jo personal, sepse komente të tilla bazohen në mentalitetin patriarkal se gratë përfaqësojnë pjesën e “ndershme” dhe të “pastër” të shoqërisë, ndërsa politika e shkatërron këtë portret ideal, të ndershëm dhe të pastër të gruas. Për më tepër, kjo temë u mbulua nga 40 artikuj në media dhe ka marrë 981 pëlqime, 516 komente dhe 220 shpërndarje. 20.3% e komenteve në Facebook që iu përgjigjën artikujve të lidhur me këtë rast përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë nxitëse ndaj deputetes Kusari-Lila.



Urrejtja online ndaj grave në politikë është shpesh e mirë-organizuar, çka tregon se kjo dhunë është sistematike dhe e paramenduar. Ndërkohë, vendimet politike që përfaqësojnë personalitetin e pavarur politik dhe pavarësinë e tyre gjykohen veçanërisht nga homologët e tyre meshkuj. I tillë është rasti me deputeten Doarsa Kica-Xhelili, e cila vendosi ta ndërrojë partinë e saj politike nga Vetëvendosje (LVV) në LDK. Pas largimit nga LVV, kundër saj u iniciua një fushatë online nga një grup në Facebook i quajtur “mekryeministrin”, i cili ka 50,000 anëtarë. Individët e këtij grupi synonin ta turpëronin deputeten për largimin nga grupi politik i kryeministrit. Për më tepër, komentet mizogjene dhe urrejtja online ndaj Kica-Xhelilit u përshkallëzuan deri në atë pikë sa të “supozohej” se ajo ishte shantazhuar. Ky dhe argumente të tjera me urrejtje në baza gjinore minojnë rëndësinë e vendimit politik të Kica-Xhelilit për ndryshimin e partisë politike. Vënia në pikëpyetje e vendimeve politike të grave përfaqëson një sjellje dhe qasje klasike patriarkale, e cila vë në dyshim aftësitë mendore të grave, por gjithashtu përhap urrejtje online kundër grave në një shoqëri tradicionale që tashmë ka perceptime të forta të pabarabarta ndaj grave në të gjitha sferat. Komentet nga audienca në Facebook në lidhje me këto artikuj të lajmeve përmbajnë **26%** të komenteve që kualifikohen si gjuhë e urrejtjes.




16.8% e komenteve në Facebook që iu përgjigjën këtij artikulli përmbanin gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë nxitëse kundrejt ministres Haxhiu. Ky artikull përmbante gjuhë diskriminuese dhe mizogjene ndaj Ministres së Drejtësisë, bazuar në normat diskriminuese shoqërore gjinore që gratë duhet të kufizohen në çështje private dhe familjare si gatimi dhe kujdesi për pamjen e tyre, por të mos ndërhyjnë dhe as të përpiqen të debatojnë me kolegët e tyre meshkuj për çështje politike. Ky lajm mori 283 pëlqime, 130 komente dhe 247 shpërndarje pasi u raportua në 43 artikuj në media.




Përkundër bagazhit politik dhe diplomatik të Vlora Çitakut – aktualisht nënkryetare e Partisë Demokratike të Kosovës, artikulli përdori gjuhë fyese dhe mizogjene ndaj zonjës Çitaku duke konsideruar se “nuk i ka hije” ta këshillojë kryeministrin Kurti. Për më tepër, ky artikull tërhoqi gjithsej 7945 ndërveprime për shkak të gjuhës akuzuese të përdorur ndaj zonjës Çitaku. Komenteve e audiencës në Facebook të lidhura me këto artikuj të lajmeve përmbajnë **14.3%** komente me gjuhë të urrejtjes.

Abuzimi online që pësojnë gratë politike drejtohet kundër gjinisë së tyre në vend që të kritikojë pikëpamjet apo veprimet e tyre politike. Në nivel global, është vënë re se dhuna ndaj grave në hapësirat online është intensive ndaj grave që shprehin opinionet dhe pikëpamjet e tyre publikisht dhe që janë aktive në jetën politike. Kështu është kundërshtimi ndaj deputetes Ganimete Musliu pasi e kritikoi kryeministrin Albin Kurti në Kuvend.



Pas fjalimit kritikues, deputetja Musliu është sulmuar verbalisht nga kolegët e saj meshkuj, të cilët i kanë kujtuar se femrat si Musliu janë djegur në mesjetë. Për më tepër, ky artikull tërhoqi një audiencë online me 15,750 ndërveprime në rrjete sociale.


Komentet e audiencës në Facebook, gjithsej 3342, për këto artikuj të lajmeve përmbajnë **27.1%** të komenteve që kualifikohen si gjuhë e urrejtjes



Në mënyrë të ngjashme, frazave të tilla si "i pakuptimtë epshi juaj për vëmendje", jo vetëm që u mungojnë argumentet thelbësore, por gjithashtu kontribuojnë në një portretizimin negativ të grave në politikë, duke i portretizuar ato si të paafta dhe të padenja, dhe që duhen parë me skepticizëm të konsiderueshëm. Sulmi verbal në këtë rast fokusohet në mënyrë eksplicite te gjinia, duke tentuar ta denigrojë imazhin e tyre në bazë të gjinisë. Përdorimi i fjalëve dëshirë dhe epsh përforcon stereotipet e dëmshme se gratë janë të motivuara kryesisht nga dëshira për vëmendje dhe aprovim. Këto komente gjithashtu mund të shihen si një formë objektivizimi dhe seksualizimi. Dhuna në baza gjinore mund të përshkallëzohet si rezultat i diskurseve të tilla. Rasti mori 370 pëlqime, 121 komente dhe 311 shpërndarje pasi u publikua në 86 artikuj në media online.

31.5% e komenteve në Facebook që iu përgjigjën këtij artikulli përmbanin gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë nxitëse kundrejt grave deputete të Kuvendit.


Një nga fushatat më të bujshme të dhunës online targetoi deputeten Mimoza Kusari-Lila në lidhje me aferën e përgjimeve dhe publicitetin rreth saj.




Kryetitujt me urrejtje të shpërndara nga media përmbanin një qasje të pastër mizogjene dhe dhunë dhe sulme online kundër deputetes Kusari-Lila. Zhvendosja e fokusit të situatës drejt gjinisë dhe jo te personaliteti politik i znj. Kusari-Lila përfaqëson një mizogjini të paramenduar dhe klasike të përdorur dhe riprodhuar nga mediat përmes pranisë së tyre në rrjete sociale. 428 artikujt në lidhje me këtë çështje të shqyrtuar për këtë raport morën 10,491 pëlqime, 8,367 komente dhe 2,226 shpërndarje.

Videot Deepfake u shfaqën edhe në platforma të tjera të rrjeteve sociale si Facebook dhe TikTok. Mimoza Kusari ishte në mesin e caqeve. . Kjo video, në kohën e analizës, kishte më shumë se 20,700 shikime dhe është ndarë gjatë një periudhe kur Kuvendi i Kosovës ishte i angazhuar në diskutime në lidhje me disa incizime mes Kusarit dhe Simiqit. **21.2%** e komenteve në Facebook që iu përgjigjën këtij lajmi përmbajnë komente me gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë nxitëse ndaj deputetes Kusari.

Gjuha dhe sjelljet mizogjene janë të pranishme në mënyrë të frikshme, veçanërisht nga politikanët meshkuj, të cilët janë zgjedhur nga shoqëria për të përfaqësuar si gratë ashtu edhe burrat. Nga ana tjetër, artikujt e përzgjedhur për këtë raport, të cilët morën numrin më të madh të ndërveprimeve, kanë treguar se në shumicën dërrmuese të rasteve, është gjuha e përdorur nga politikanët meshkuj kundër kolegëve të tyre ajo që i ka përhapur në media ngacmimet dhe dhunën online kundër grave në politikë. Përkundër shkallës së pushtetit politik që ka një grua, ajo nuk kursehet nga komentet dhe qëndrimet mizogjene nga kolegët e saj meshkuj në politikë. I tillë është rasti me shkrimet që kanë të bëjnë me Presidenten e Republikës së Kosovës – Vjosa Osmani.





Presidentja Osmani konsiderohet si patericë dhe kukull për gjynah që përdoret nga qeveria e Albin Kurtit. Qasja mizogjene dhe përzgjedhja e këtij artikulli për këtë raport bazohet në ndërveprimet dhe vëmendjen online që mori, por edhe në sulmin negativ online që solli. Përpjekjet për të minuar pushtetin politik të Presidentes Osmani bazohen në gjininë e saj, duke u bazuar në perceptimin shoqëror se gratë, pavarësisht nga pozita e tyre e lartë shoqërore, janë gjithmonë të nënshtruara dhe jo të barabarta me homologët e tyre meshkuj. Ky artikull mori 225 ndërveprime, 102 pëlqime, 112 komente dhe 41 shpërndarje, teksa **25%** e komenteve në Facebook që iu përgjigjën këtij artikulli përmbanin gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë nxitëse ndaj Presidentes Osmani.



Një rast shtesë i cenimit të pushtetit politik dhe bagazhin e grave është artikulli që nënkryetaren e PDK-së Vlorë Çitaku e paraqet si “grua e shkretë”. Artikulli mori gjithsej 3,673 ndërveprime, ndërsa 38.9% e tyre përmbanin komente me gjuhë të urrejtjes që synonin të nënvlerësonin pozicionin politik të znj. Çitaku dhe ta shtynin atë në një pozicion dytësor mbështetës. Narrativa e këtij artikulli përjetëson nocione stereotipe në lidhje me gratë në politikë, duke i pozicionuar ato në role mbështetëse dhe inferiore në krahasim me homologët e tyre meshkuj.

07 Maj 2022



Mediat turke: Osmani ka kryer ndërhyrje në Turqi për të rënë në peshë, qëndroi në hotel me 5 yje

07/05/2022 13:40



121
Artikuj në media

6,304 pëlqime

5,300 komente

781 shpërndarje



Like



Comment



Share

Urrejtja dhe mizogjia online kundër Presidentes Osmani dhe tentativat për të minuar pushtetin e saj politik janë shprehur në artikujt që gjykojnë pamjen e Presidentes Osmani. Artikulli i parë gjykon humbjen në peshë të Presidentes Osmani, çka ndezi një debat publik rreth operacionit për humbje peshe të Presidentes Osmani. Vëmendja publike që tërhoqi ky artikull solli gjithsej 14,304 ndërveprime në rrjete sociale, ndërsa 13.2% e komenteve janë të cilësuar si gjuhë e urrejtjes duke u fokusuar veçanërisht në ofendime për fizikun.

Ndërkohë, artikulli tjetër e përfaqësonte Presidenten Osmani si “vajzë Instagrami” duke targetuar pamjen e jashtme të Presidentes Osmani. Qasja mizogjene ndaj grave në politikë përfshin komentimin dhe nxjerrjen në pah të pamjes së jashtme të grave në vend të pikëpamjeve, fuqisë dhe vendimeve të tyre politike, duke nënkuptuar vlerën estetike të gruas dhe jo cilësinë dhe aftësinë mendore të gruas, çka është në përputhje me përfaqësimin patriarkal të gruas në shoqëri dhe glorifikimin e pamjes së jashtme të saj, ndërkohë që diskriminohet intelektin e tyre. Ky artikull u nda në 7 media/portale të tjera online dhe mori gjithsej 2,834 ndërveprime në rrjete sociale.

Komentet e audiencës në Facebook të lidhura me këto artikuj të lajmeve përmbajnë 19% komente me gjuhë të urrejtjes.

12 Qershor 2023



Gazetari nga Tirana: Vjosa vajzë Instagrami që ka në agjendë urrejtjen ndaj Shqipërisë



9
Artikuj në media

1,282 pëlqime

1,085 komente

87 shpërndarje



Like



Comment




Share




Përplekjet për të nënvlerësuar pjesëmarrjen politike të grave në politikë, përmes urrejtjes online, janë një tjetër pasojë e rëndë e mizogjinisë. I tillë është lajmi që tentoi ta “turpëronte” deputeten Blerta Deliu për daljen nga salla gjatë seancës plenare në Kuvendin e Kosovës pasi menjëherë pasi ishte nënshkruar për mëditje. Ky lajm është transmetuar në 14 media dhe ka marrë 3020 pëlqime, 1810 komente dhe 183 shpërndarje. 34.4% e komenteve në Facebook që iu përgjigjën këtyre artikujve përmbanin gjuhë të urrejtjes komente dhe gjuhë nxitëse kundrejt deputetes Deliu.

Dhuna online kundër grave në politikë i ka targetuar gratë edhe duke komentuar dhe përhapur urrejtje online kundër zgjedhjeve të tyre personale në lidhje me jetën dhe familjen.


Urrejtja online kundër deputetes Ardiana Matoshi lidhet me zgjedhjet e saj personale, ndërkohë që lidhja e saj me një burrë me ngjyrë e bëri deputetin Matoshi cak të dhunës online ku përfshiheshin komente seksiste dhe raciste kundër saj. Videoja fillestare në rrjete sociale mori rreth 2,000 komente, ndërsa riprodhimi i artikullit gjeneroi 11.5% komente me gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë nxitëse.






Ndërkohë deklarata e deputetes Saranda Bogujevci se ka vendosur të ketë fëmijë pa u martuar dhe pa pasur burrë, shkaktoi shumë ngacmime negative me urrejtje dhe dhunë online kundër deputetes Bogujevci. Gjykimi i saj kryesisht u shqiptua nga figura fetare që u përpoqën ta “turpëronin” për veprimet e saj si “sfiduese ndaj Zotit”, ndërsa e etiketonin atë si të pamoralshme. Komentet e bëra nga audienca në Facebook në lidhje me këto artikuj përmbajnë 12.7% të komenteve të identifikuara si gjuhë e urrejtjes.

Dhuna online që përfshin një situatë që riprodhohet nga media ose në rrjete sociale, i riviktimizon gratë e targetuara. I ngjashëm është edhe përdorimi i gjuhës fyese ndaj grave në politikë apo gazetare, të cilat përfaqësojnë një përqindje të madhe të grave cak i dhunës dhe ngacmimeve online. Analizimi dhe kontekstualizimi i urrejtjes dhe mizogjinisë online varet nga themeli social i pabarazisë dhe diskriminimit gjinor. Kështu, urrejtja dhe abuzimi mizogjen online nuk janë gjë tjetër veçse një manifestim digjital i dhunës ndaj grave, ndërkohë që gratë gazetare janë një nga caqet më të shpeshta dhe më të rrezikuara.




Ofendimi online i grave të përfaqësuara në këtë raport bëhet përmes shumicës së artikujve ndërveprues. Në rastin e parë, kritikën publike ndaj Granit Xhakës (futbollist kosovar në Zvicër) për gjestin e tij krijuan një furtunë të urrejtjes online kundër gazetares Zana Avdiu. Të 306 artikujt për këtë rasti kanë marrë 16,443 pëlqime, 14,113 komente dhe 1,514 shpërndarje, ndërsa sipas avokatit të Avdiut, ajo pas deklaratës së saj ka marrë 11,000 kërcënime.


Besarta Hoti – gazetare, është quajtur “budallaqe” në një konferencë për media kur ka bërë një pyetje jo të dëshirueshme lidhur me punësimet familjare. Nga ana tjetër, gazetarja Dafina Demaku u etiketua si “agjente e BIA-s serbe” duke iniciuar një fushatë shpifjesh për ta linçuar publikisht si agjente e dyshuar serbe. Ndërsa poshtërimi publik i një gruaje gazetare ngre supozimin se është paaftësia e grave/gjinisë për të bërë pyetje të duhura. Ky artikull mori gjithsej 3,878 ndëreveprime në rrjete sociale, ku 26.7% e komenteve përmbanin gjuhë të urrejtjes. Në mënyrë të ngjashme, fushata në rrjetin social TikTok kundër gazetares Dafina Demaku, duke e etiketuar atë si agjente të BIA-s serbe dhe duke e përshkruar në disa video si “gazetare pro-serbe” dhe “agjente e dyshuar e BIA-s serbe”, shërben si shembull klasik i dezinformimit gjinor, pasi jo vetëm shpërndan informata të rreme, por gjithashtu targeton në mënyrë specifike individët bazuar në gjininë e tyre. Një rast i përsosur i një fushate të shpifjeve dhe linçimit të një gruaje në një profesion publik si gazetarja. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e kritikoi fushatën kundër gazetares dhe u kërkoi zyrtarëve të sigurisë të shqyrtojnë se kush qëndron pas profilit në rrjetin social TikTok që mbante emrin Qeveria Kurti 2.



Rasti u mbulua nga 28 artikuj në media dhe ka marrë 318 pëlqime, 312 komente dhe 166 shpërndarje.


Komentet e audiencës në Facebook të lidhura me këto artikuj të lajmeve përmbajnë 30.3% komente me gjuhë të urrejtjes.





Shkrimi me titull “‘Ik, moj idiote’, Kimete Berisha reagon ndaj ministres Nagavci”, është një nga shkrimet e publikuara në portalet online, i cili ka përdorur gjuhë fyese ndaj ministres së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arbërie Nagavci. Ajo u quajt “idiote” nga gazetarja. Ky artikull ka gjeneruar 302 reagime në rrjete sociale.

Komentet e audiencës në Facebook të lidhura me këto artikuj të lajmeve përmbajnë **30.1%** komente me gjuhë të urrejtjes.




Gratë në arenën publike, qoftë në politikë, gazetari apo profesione të tjera, shpesh gjyko-hen në bazë të pamjes së jashtme, modelit të flokëve, veshjes, peshës e kështu me radhë, ndërsa aftësitë, kualifikimet dhe kapacitetet e tyre profesionale shpesh neglizhohen. Sulmet ndaj pamjes fizike mund të ndodhin kur nuk ka kundërargumente për kualifikimet e tyre profesionale. I tillë është edhe komenti ndaj Flutura Kusarit, një juriste e cila u kritikua në lidhje me flokët e saj teksa avokonte për një nga çështjet mediatike.

Diskursi i urrejtjes kundër komuniteteve të margjinalizuara

Në një anketë të kryer nga Revista Forbes në korrik 2023, urrejtja dhe ngacmimi online ndaj personave LGBTQI+ është rritur për 52% nga viti i kaluar. Si të rriturit ashtu edhe adoleshentët raportuan se janë ngacmuar online, por me përqindje më të larta këtë vit.⁸ Ngacmimet u rritën në të gjitha kategoritë, duke përfshirë edhe kundër pakicave etnike dhe personave LGBTQI+.

Ky raport tregon dy artikuj me ndërveprim të lartë, të cilët përfshijnë gjuhë të urrejtjes dhe ngacmime kundër komuniteteve të margjinalizuara si personat me aftësi të kufizuara dhe personat LGBTQI+.

Toni i lartë patriarkal në shoqërinë kosovare i ka sulmuar gratë në politikë jo vetëm për zgjedhjet e tyre personale por edhe për jetën e familjarëve të tyre. Po kështu është edhe gjuha e urrejtjes dhe raciste në mediat online që mori 6,230 pëlqime, 828 komente dhe 1,300 shpërndarje në 133 media.




Komentet homofobike i pushtuan rrjete sociale pas publikimit të lajmit. Në reagim, Qendra për Barazi dhe Liri e komunitetit LGBTQI+ në Kosovë, së bashku me personalitete publike dhe ambasada, i kritikuan këto komente, duke theksuar se homofobia nuk ka vend në shoqëritë moderne. . Kjo çështje nxjerr në pah jo vetëm mungesën e gatishmërisë së shoqërisë sonë për ndryshim, por edhe tendencën për t'i shfrytëzuar familjarët më të afërt të personazheve publike si mjete për t'i minuar personalitetet publike. Komentet e audiencës në Facebook të lidhura me këto artikuj të lajmeve përmbajnë 15.3% komente me gjuhë të urrejtjes.

⁸ <https://www.forbes.com/sites/petersuciu/2023/07/01/online-hate-and-harassment-on-the-rise-lgbtq-community-among-the-most-impacted/?sh=47f50e447f91>

Ulja poshtë e personave me aftësi të kufizuara dhe grave

Një artikull i cili përmbante gjuhë fyese ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe grave ishte artikulli me titull "Si m'i lypë qorrit sy, Si gra t'kqija - Pse në Kuvend vet përfaqësuesit e popullit ofendojnë popullin". Ky lajm është publikuar pas deklaratave të bëra në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për përdorimin e një gjuhe të tillë ka pasur një reagim nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës, duke kërkuar të të mos publikohen terma të tillë, dhe duke bërë thirrje që të mos përdoret një gjuhë e tillë. Ky lajm mori gjithsej 907 ndërveprime në rrjete sociale.



Komentet e audiencës në Facebook të lidhura me këto artikuj të lajmeve përmbajnë 36.2% gjuhë të urrejtjes

Rekomandime

- 1** Komunitetet lokale duhet të udhëheqin veprime, t'i zmadhojnë dhe gjejnë burime për zgjidhje lokale për të rritur vetëdijesimin dhe për të ndryshuar mentalitetin në lidhje me dhunën online kundër grave.
- 2** Komuniteti mediatik dhe shoqëria duhet të respektojnë kodin etik në kuadrin e mediave të shkruara dhe në kuadrin e institucioneve ku bëjnë pjesë: ose Komisioni i Pavarur për Media ose Këshilli i Mediave të Shkruara.
- 3** Shpesh partitë politike zgjedhin gra të papërgatitura për debate televizive dhe përfaqësim të partive politike, vetëm për të përmbushur kuotën gjinore. Andaj, për përfaqësimin e tyre në media partitë politike duhet t'i motivojnë dhe mbështesin gratë fillimisht, në mënyrë që të paraqiten gra të përgatitura dhe të informuara.
- 4** Edukim mediatik në shkolla dhe në të gjitha segmentet e shoqërisë. Është e rëndësishme të promovohet vetëdijesimi për të njëjtën linjë të standardeve të sjelljes. Siç nuk nuk lejohen sjelljet e ashpra fizike, ashtu nuk është e pranueshme që kjo të ndodhë online.
- 5** Gjuha e dhunshme e përdorur në rrjete sociale shkon përtej çdo përkufizimi etik ekzistues ose mase ekzistuese apo që mund të ndërmerret. Pra, duhet të jemi më të përgjegjshëm në raportimin e rasteve, sidomos të rasteve që janë skandaloze. Nëse marrim iniciativën për raportimin e rasteve do të ketë dallime dhe kemi shembuj të mirë nga ky aspekt nga reagimi i institucioneve përgjegjëse si Prokuroria dhe Policia e Kosovës. Ka një numër të rasteve kur njerëzit janë dënuar për përdorimin e gjuhës së urrejtjes ose kërcënimeve. Pra, kjo është një përgjegjësi e të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë.
- 6** Duhet të vazhdojë lufta kundër dezinformimit. Shoqëria ka arritur në pikën e vetëdijesimit dhe qytetarët kanë kureshtje dhe janë të interesuar për ndikimin e dezinformimit. Pra, kjo është një betejë e qytetarisë aktive kundër një fenomeni ekstrem.
- 7** Duhet të rritet kapaciteti financiar i mediave. Mediave u mungojnë financimi publik dhe financimi i pavarur për ngritjen e kapaciteteve. Edhe pse rrjetet sociale kanë fuqi të madhe, fuqia e mediave është më tepër e përqendruar në media klasike, prandaj redaktorët luajnë rol të rëndësishëm. Duke qenë se hulumtimi tregon se një numër i madh i lexuesve nuk e lexojnë informacionin përtej titullit, është e rëndësishme të shqyrtohet se kush qëndron pas atyre titujve.
- 8** Puna me influencerë në media. Ka persona të caktuar që gëzojnë një ndikim më të madh në opinionin publik, ndaj është e rëndësishme të punohet me ta. Opinioneve të influencerëve u jepet rëndësi e madhe; prandaj është e rëndësishme që influencerët të mësojnë për përgjegjësinë që kanë kur shprehin opinione.

Mostra e gjuhës së urrejtjes – sipas gjinisë

Tabela e mëposhtme tregon gjininë e personave që komentojnë me gjuhë të urrejtjes, të ndarë në secilën temë veç e veç.

Nr.	Temat	Gjinia (%)	
		 M	 F
1	Besarta Hoti (gazetare) kundër Xhelal Sveçla (qeveria)	92	8
2	Bislimi (qeveria) kundër Ariana Musliu – Shoshi (deputete)	94	6
3	Blerta Deliu (deputete)	94	6
5	Dafina Demaku (gazetare)	96	4
6	Elena Stublla (mësimdhënëse)	92	8
7	Florentina Gjergjaj (drejtoreshë shkolle)	92	8
10	Ganimete Musliu (deputete) kundër Albin Kurti (qeveria)	86	14
11	Rita Ora me flamur serb	92	8
12	Rron Gjinovci kundër Flutura Kusari (gazetarë)	97	3
13	Adnan Rrustemi (deputet) kundër Valentina Bunjaku (deputete)	96	4
14	Saranda Bogujevci (deputete)	94	6
15	Albulena Haxhiu (deputete) kundër Abelard Tahiri (deputet)	96	4
17	Rënia në peshë e Vjosa Osmanit (Presidente)	78	22
18	Martesa e vëllait të Mimoza Kusarit (deputete)	96	4
19	Përgjimi Kusari – Simiq (deputetë)	90	10
20	Zana Avdiu (gazetare) kundër Granit Xhaka (lojtar)	96	4
21	Doarsa Kica Xhelili linçohet me të madhe në grupin “mekryeministrin”	88	12
22	Baton Haxhiu: Zëdhënësja e Përjetshme e Pushtetit foli edhe për të brendshmet e saj	98	2
23	Limaj për Presidenten Osmani: Kukull për gjynah e patericë e qeverisë Kurti	90	10
24	Gazetari nga Tirana: Vjosa vajzë Instagrami që ka agjendë urrejtjen ndaj Shqipërisë	94	6
26	I dashuri i Adriana Matoshit	98	2
27	Kimete Berisha kundër Arbërie Nagavci	96	4
29	E shkreta grua Vlora, po e mbron, por shefi i saj është burgosur për urdhërdhënie e vrasje të pro-amerikanëve	88	12
30	Dimal Basha - Ulja poshtë e personave me aftësi të kufizuara dhe grave	98	2
31	Vlora Çitakut s’i ka hije ta këshillojë Albin Kurtin e qeverinë	97	3

